



**VENDIM**

**Nr. 20, Datë 16.02.2016**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË  
“HEC LASHKIZA” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “LASHKIZA 1” ME FUQI TË  
INSTALUAR 4076 KW DHE “LASHKIZA 2” ME FUQI TË INSTALUAR  
882 KW (ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 4958 KW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Lashkiza” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec-et, “Lashkiza 1” dhe “Lashkiza 2”

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “Hec Lashkiza” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “Hec Lashkiza” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Lashkiza 1” me fuqi të instaluar 4076 kW dhe “Lashkiza 2” me fuqi të instaluar 882 kW (me fuqi totale të instaluar 4958 kW).
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.